



Prishtinë: 24.12.2012

Kodi i ZRRE-së: V_491_2012

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_875_10_12

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreu IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_875_10_12**; dhe
5. Ankesën e konsumatorit me datë 05.12.2012;

Në mbledhjen e mbajtur më 24 dhjetor 2012, nxori këtë:

VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit A. S. (shifra në KEK: DPZ – 66289) nga fshati Sopijë, Komuna e Therandës ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_875_10_12 i datës 29.12.2012

Arsyetim

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 13.05.2008 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 7537459 dhe kanë vendosur për matje njehsorin e vet elektrik nr. 1771475.

Pas kësaj punëtorët e autorizuar të Qendrës së Kalibrimin të KEK-ut me datë 10.07.2008 kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 7537459 ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka në rregull, nga ana e jashtme qelqi i njehsorit i krisur, për rreth qelqit nga ana e djathtë është futur shiriti filmik, është penguar puna e diskut si dhe në brendi të njehsorit ka pluhur të shiritit filmik. Pas procesverbalit të kalibrimin punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 24.10.2008 kanë dalur te konsumatori dhe kanë evidentuar të dhënat teknike të pikës matës.

Departamenti i Faturimit në KEK me datë 19.01.2009 e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPZ09HP04604 në vlerë prej 2,312.81€. Pas kësaj ngarkese të bërë nga KEK-u konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike. Departamenti për Konsumator në KEK pas ankesës së bërë nga konsumatori ka shqyrtuar lëndën e konsumatorit dhe ka refuzuar ankesën e tij. Konsumatori pas marrjes së përgjigjes nga ana e KEK-ut, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me të cilin ka kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 29.10.2012 ka nxjerr vendim duke **refuzuar** ankesën e konsumatorit dhe duke obliguar



konsumatorin që të paguaj borxhin e ngarkuar nga KEK-u në faturën e rikthimit të humbjeve DPZ09HP04604 të datës 19.01.2009 në vlerë prej 2,312.81€.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, më datë 10.10.2012 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, me të cilën ka kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_875_10_12 të datës 29.10.2012. Konsumatori në ankesë thekson se konstatimi i bërë nga qendra e kalibrimit është bërë pa pjesëmarrjen e palës së tretë, si dhe procesverbali i kalibrimit nuk mund të merret si prove meritore. Në vazhdim të ankesës theksohet se procesverbali i plotësuar me konstatimet teknike duhet të dërgohet se komisioni i cili do të jetë i përbërë prej së paku prej tre anëtarëve, një nga OSSH, ndërsa dy nga furnizuesi, i cili komision analizon procesverbalin e inspektimit dhe të kalibrimit.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.12.2012 ka shqyrtuar dhe analizuar dëshmitë e paraqitura nga konsumatori, përkatësisht kundërshtimet e theksuara në ankesë ndaj vendimit të DMK-së.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar procesverbalin e KEK-ut të datës 13.05.2008 dhe ka vërejtur se punëtorët e KEK-ut kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik si dhe përveç ndërrimit të njehsorit elektrik kanë evidentuar se njehsori elektrik nr. 7537459 është i dëmtuar (krisur). Përveç procesverbalit të kontrollës është analizuar edhe procesverbali i qendrës së kalibrimit nr. 19/10 të datës 10.07.2008 në të cilën është konstatuar se njehsori elektrik nr. 7537459 vulat (bllombat) shtetërore i ka në rregull, nga ana e jashtme qelqi i njehsorit i krisur, për rreth qelqit nga ana e djathtë është futur shiriti filmik, është penguar puna e diskut si dhe në brendi të njehsorit ka pluhur të shiritit filmik, si dhe ka vërejtur se kontrollim detal i njehsorit elektrik është bërë pa pjesëmarrjen e palës së tretë, përfaqësuesve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë apo përfaqësuesve të institucioneve të pavarura.

Bordi i ZRRE-së përveç procesverbalit të kalibrimit nr. 19/10 të datës 10.07.2008 ka analizuar edhe fotografit e kalibrimit të njehsorit elektrik nr. 7537459 me të cilat ka vërejtur të gjeturat e evidentuara në procesverbalin e kalibrimit përkatësisht që njehsori elektrik është i dëmtuar fizikisht, ka qelqin e krisur dhe që në brendi të njehsorit ka pluhur.

Bordi ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike të shifrës së konsumatorit DPZ – 66289 dhe gjatë analizimit ka vërejtur se, mesatarja mujore si dhe vjetore e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor elektrike të vjetër nr. 7537459 dhe me njehsor elektrike të ri nr. 1771475 ka ndryshim të madh. Mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik nr. 7537459 prej periudhës 08/2002 deri më 04/2008 është 61 kWh/muaj, ndërsa me njehsor të ri elektrik për periudhën 05/2008 deri më 09/2012 është 496.64 kWh/muaj, e që e shprehur në përqindje vërehet qartë se me njehsor elektrik të ri nr. 1771475 ka një rritje të shpenzimit të energjisë elektrike prej 714% në krahasim me shpenzimin e energjisë elektrike të regjistruar në njehsorin elektrik të vjetër nr.7537459.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të gjitha proceseve të KEK-ut, dhe ankesës së konsumatorit konstaton se Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka vepruar drejt në vendimin e tij.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 30.11.2012 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. **ZRRE/DMK_V_875_12_12**, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmime tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar